



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. 268/1 Prot.

Vlorë më, 22.02.2022

VENDIM
Nr. 8, datë 21.02.2022

PËR
ZGJEDHJEN E ANËTARËVE, NË KOMISIONIN INSTITUCIONAL ZGJEDHOR TË
STUDENTËVE SI DHE NË KOMISIONIN E APELIMIT TË STUDENTËVE NË
UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORË

Në mbështetje të nënit 38, pika 1, gërma a të Ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" si dhe nenin 6 të rregullores "Për zgjedhjen e këshillave studentorë në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë", Senati Akademik në mbledhjen e datës 21.02.2022

VENDOSI:

1. Të votojë për 12 (dymbëdhjetë) kandidaturat e vlefshme nga vetëkandidimet për anëtarë në Komisionin Institucional Zgjedhor të Studentëve dhe në Komisionin e Apelimit të Studentëve, nga të cilat 5 (pesë) për në Komisionin Institucional Zgjedhor të Studentëve dhe 3 (tre) për në Komisionin e Apelimit të Studentëve.
2. Në fund të procesit të votimit, të shpallë fitues për në:
 - a. Komisionin Institucional Zgjedhor të Studentëve studentët e më poshtë shënuar:

| | |
|-----------------|---------------------------------------------|
| Erika Mingaj | Fakulteti Ekonomisë |
| Taulant Briku | Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë |
| Mateo Selfo | Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore |
| Ariela Çerçizaj | Fakulteti i Shëndetit |
| Anxhela Hasanaj | Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore |

- b. Komisionin e Apelimit të Studentëve, studentët e më poshtë shënuar:

| | |
|------------------|---------------------------------------------|
| Ken Hallanjaku | Fakulteti Ekonomisë |
| Evelina Haxhiraj | Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë |
| Sara Malaj | Fakulteti i Shëndetit |

3. Të zgjedhë sekretar të Komisionit Institucional Zgjedhor të Studentëve, studenten Anxhela Hasanaj, Fakulteti i Shkencave Teknike dhe Natyrore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe bëhen njoftimet përkatëse.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof. Dr. Roland ZISI

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288

Faqe 1 nga 1

